1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

1. “Organizimi i ceremonive zyrtare dhe përkujtimore të datave historike”

Këtu përfshihen blerjet e kurorave me lule si dhe luleve të freskëta për të bërë homazhe në buste, lapidarë dhe pllakatat përkujtimore të heronjve dhe dëshmorëve të luftës për ditët e shënuara historike: Beteja e Margëlliçit, Dita e Dëshmorëve, formimi i Batalionit të Sheqishtës dhe festa e Çlirimit të Atdheut.

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
1	Kurora me lule	copë	21
2	Buqeta me lule	copë	25

Specifikimet:

1.Kurorat duhet të jenë përgatitur me lule të freskëta.

2.Buqetat duhet të jenë me lule të freskëta shumëngjyrëshe dhe të paketuara me material cilësor.

3.Numri i kurorave dhe buqetave me lule do të porositen sipas festës apo ngjarjes historike që përkujtohet, 1(një) javë para organizimit .

2. Organizimi i aktivitetit “Në nder të grave të komunitetit”

Duke qenë se Muaji Mars përkon me festën e Gruas gjatë muajit do të organizohet aktiviteti “Në nder të grave të komunitetit” për të vlerësuar punën e palodhur, sakrificën dhe kontributin e gruas në familje dhe shoqëri. Ky aktivitet i cili do të organizohet në një nga lokalet e qytetit është konceptuar si një drekë festive i gërshtuar me program muzikor .

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
1	Organizimi i aktivitetit	persona	100
2	Lule trëndafil dhe karajfil të mbështjell në letër telefoni me motive festive dhe fjongo	copë	300

Specifikimet e organizimit të aktivitetit:

1.Lokali ku do të organizohet aktiviteti duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë Patos për të bërë të mundur transportin e pjesëmarrësve.

2.Lokali duhet të ketë DJ për të krijuar atmosferë festive.

3.Menuja që do të serviret të jetë si më poshtë:

- Pjata e parë - mish viçi me patate në furrë
- Pjata e dytë - sallatë mesore (sallatë jeshile, rukola, perime të ziera)
- Salcë kosi
- Një pije freskuese (cola ose fanta, ujë, verë ose birra),
- Fruta të freskëta (mollë, banane, portokalle etj...)
- Ëmbëlsirë (pjesë torte).

3. Aktiviteti “Beteja e lirisë”

Në datën 29 mars do të organizohet një aktivitet me Organizatat e Veteranëve dhe Familjeve të Dëshmorëve të qytetit me rastin e 82-vjetorit të Betejës së Margëlliçit. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë pasardhës veteranësh të luftës, familjarë të dëshmorëve të qytetit, të ftuar nga Komiteti Kombëtar i Veteranëve dhe Komiteti i Veteranëve të Fierit, përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor si dhe intelektualë të qytetit.

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
/	Organizimi i aktivitetit	Persona	80

Specifikimet e organizimit të aktivitetit:

1.Lokali duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë Patos për të bërë të mundur transportin e të ftuarve si dhe organizimin e aktivitetit me infrastrukturën e nevojshme.

2.Të ftuarve do t'u serviret menuja si më poshtë :

- 1(një) pije freskuese (lëng frutash, coca cola, fanta)
- Fruta të freskëta (mollë, portokalle, kivi, banane)
- Ëmbëlsirë (trileçe ose pjesë torte).

4. Aktiviteti “Shfaqje teatri”

Ky aktivitet parashikon vënien në skenë të shfaqjeve teatrale për të rritur dhe për fëmijë nga Teatri Kombëtar ose teatrot e rretheve në periudha të ndryshme të vitit. Numri i shfaqjeve varet nga tematika, numri i personazheve dhe niveli artistik i saj.

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
1	Shfaqje teatri për fëmijë dhe të rritur	aktivitet	2

Specifikimet teknike :

- Shfaqja teatrale për fëmijë duhet të jetë e përshtatshme me moshën dhe argëtuese.
- Shfaqja teatrale për të rritur duhet të jetë e përshtatshme për publikun, me fjalor jodiskriminues.
- Artistët, stafi teknik dhe stafi realizues marrin përsipër vet shpenzimet e transportit.

5. Aktiviteti “Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe turizmit”

Gjatë vitit 2026 do të organizohen disa aktivitete në fushën e trashëgimisë kulturore dhe turizmit për të promovuar trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale, si dhe tërheqjen e vizitorëve lokalë dhe më gjerë drejt atraksioneve natyrore dhe kulturore që ka zona jonë. Materialet e propozuara synojnë të ofrojnë informacion të strukturuar dhe të verifikuar mbi asetet kulturore, destinacionet turistike dhe aktivitetet përkatëse.

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia	Sasia
1	Fletëpalosje	copë	300
2	Harta turistike	copë	2

Specifikimet teknike

1. Fletëpalosjet duhet të jenë cilësore (flyer/brochure) me material kartoni. Formatit të jetë praktik dhe profesional. Palosja duhet të jetë në varësi të përmbajtjes së shkrimit dhe zmadhimit të fotos me rezolucion. Renditja e shkrimit dhe fotove të fletëpalosjes do të realizohet nga shtëpia botuese do të kontrollohet nga specialistët e bashkisë përpara botimit për të vijuar më pas me kopjet e tjera.

2. Harta turistike të jetë me material peçikllas , sipërfaqja me përmasa 4m². Operatori duhet të bëjë dizajnin e hartës. Në hartë duhet të paraqiten pikat turistike të zonës sonë që mund të vizitohen. Harta duhet të shoqërohet me profile metalike që do të shërbejnë për montimin e saj. Harta do të dorëzohet me proces-verbal dhe faturë tatimore pranë bashkisë.

6. Projekti “Patosi’fest”

Organizohet në 23 qershor dhe është festa e qytetit e cila përkon me 77-vjetorin e krijimit të tij. Patosi është qytet i krijuar në vitin 1949 me profil industrial me njerëz nga qytete e krahina të ndryshme shqiptare të cilët u bënë banorë të tij duke ndërthurur me banorët

vendas kulturat e tyre. Ndaj dhe qëllimi i kësaj feste është bashkëjetesa qytetare dhe promovimi i vlerave historike e kulturore të tij në 77 vite.

A. Do të ketë disa aktivitete gjatë javës me karakter historik, kulturor dhe artistik ku të gjejnë veten të gjitha moshat.

B. Festimet do të mbyllen me koncertin festiv ku do të përfshihen të gjitha rrymat muzikore. Do të organizohet në orën 20:00 në sheshin para Pallatit të Kulturës me këngëtarë të njohur të muzikës popullore e moderne.

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
1.	AKTIVITET KULTUROR-ARTISTIK	aktivitet	2
2	KONCERTI FESTIV	koncert	1
/	<i>Shpenzime për dekorin</i>		
1.	Postera për njoftim	copë	10
2.	Materiale dekori	komplet	1
/	<i>Pagesa për artistët</i>		
1.	Këngëtarë të muzikës popullore	person	4
2.	Këngëtar të muzikës së lehtë (Hip-Hop, R&B)	person	2
3	Grup i valleve popullore	grup	1
4	Moderator	person	1
/	<i>Shpenzime teknike</i>		
1.	Ofrim shërbimi me foni me panel qendror komandimi	komplet	1
2.	Ofrim shërbimi me dritëzim i automatizuar me panel qendror	komplet	1
3.	Ofrim shërbimi me stage podium	copë	1

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË ORGANIZIMIT TË AKTIVITETIT KULTUROR – ARTISTIK

1. Mund të përfshihen gjini të ndryshme të artit si:
 - a. Shfaqje teatri për fëmijë ose të rritur,
 - b. Shfaqje filmi kinematografik ose dokumentar,
 - c. Ekspozitë pikturash, fotografish ose filatelik.
2. Aktivitetet duhet të jenë për fëmijë dhe të rritur, të përshtatshme me moshën, argëtuese për publikun, me fjalor jodiskriminues.
3. Artistët, stafi teknik dhe stafi realizues marrin përsipër vet shpenzimet e transportit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË ORGANIZIMIT TË KONCERTIT

Specifikimi i bazës materiale teknike (ndriçim, foni, stage podium) :

1. Fonia duhet të jetë e tipit Array line e cila nënkupton një foni ku bokset qëndrojnë të varur pas skelerisë metalike e cila do të jetë 8 metra e gjerë dhe 5 metra e lartë. Ky tip fonie është i përshtatshëm për aktivitete në terrene të hapura ku fuqia maksimale mund të shkojë rreth 15.000 wat

2. Sistemi i ndriçimit të përfshijë efektet speciale prozhektore ,blindera, robota, makinë tymi, mikser ndricimi , led etj.

3. Stage podium duhet të jetë me material alumini me përmasa 6m me 4m.

Fonia dhe ndriçimi duhet të përfshijë këto elementë:

-
1. Sub dopio 18 inch nga 1500wat rms 3000 wat peak totale 12.000 wat peak 141 db.
 2. 8 copë bokse satellite array line nga 600wat rms 1200wat peak totale 9600wat peak 136 db
 3. Mikser me 32 kanale
 4. Blinder 2 copë me nga 8 llampa 650 wat secila ne totale 10.400 wat
 5. Makine tymi 2000 wat
 6. Flash strobo 2 copë nga 1500 wat se cila 3000 wat në totale
 7. 6 copë par led nga 7x 10 wat RGB secila per totale 420 wat led
 8. Robota beam 7r osram 4 copë 230 wat secila
 9. Mikser ndriçimi
 10. Scaner dmx 250 wat secila 7 copë
 11. Dream light 250 wat
 12. Robota 575 wat spot
 13. Mikrofona me valë
 14. Skeleria metalike 8 metra gjerësi dhe 5metra lartësi për vendosjen e bokseve array line dhe vendosjen e ndricimit ndryshe skeleria e fonisë dhe ndriçimit
 15. Gjeneratorë 30 kwat

Specifikimi për posterat:

- 1.Duhet të jenë me ngjyra ku të dallohen qartësisht artistët që do të performojnë si dhe vendin, orën e datën e saktë të eventit.
- 2.Përmasat e posterit duhet të jenë 0.8 m x 0.8 m, lloji i letrës duhet të jetë më shumë se 55gsm.
- 3.Dokumenti duhet të jetë i printuar vetëm në një faqe me dimensionet e përgjithshme të faqes 800mm x 800mm (h).
- 4.Margjinat e posterit duhet të jenë jo më shumë se 3mm, imazhi duhet të printohet në cilësinë 300dpi ose më shumë.

Dekori duhet të jetë në përshtatje me tematikën e festës, pra t'i dedikohet qytetit të Patosit. Mund të përfshihen postera me peizazhe të zonës, lule, tullumbace etj.

Specifikimi për artistët:

- 1.Operatori duhet të paraqes listën e këngëtarëve që do të sjell.
- 2.Programi muzikor duhet të jetë rreth 120 minuta (+,-5 minuta)(duke përfshirë daljet e moderatorit, falenderimet dhe përshëndetjet).

Këngëtarët e muzikës popullore:

- 1.Duhet të jenë nga të gjitha trojet shqipfolëse dhe të pëlqyer nga publiku me hitet e këtij viti.
2. Preferohen këngëtarë popullorë të krahinave të jugut (mallakastër, myzeqe, çamëri,labëri).

Këngëtarët e muzikës së lehtë :

- 1.Duhet të jenë nga të gjitha trojet shqipfolëse dhe të pëlqyer nga publiku.
- 2.Të kenë këngë hite në repertorine tyre (mundësisht të këtij viti).
3. Rryma muzikore që do të performohet të jetë gjithpërfshirëse: Hip-Hop, R&B, Balada, Tekno, Rrok.

Grupi i valleve popullore:

1. Grupi të ketë në përbërje të tij vallëtarë djem dhe vajza.
2. Duhet të jenë me veshje tradicionale nga të gjitha krahinat shqiptare dhe të performojë valle tradicionale të këtyre krahinave.
3. Të shoqërojnë këngëtarët popullor në skenë gjatë performancës së tyre.

Moderatori :

1. Të ketë rrjedhshmëri në të folur.
2. Të ketë paraqitje skenike.
3. Të ketë eksperiencë të mëparshme në moderim.

7. Projekti “Brez pas brezi myzeqar!”

Festa e Njesisë Administrative Zharrëz organizohet në 29 shtator për promovimin dhe trashëgiminë e vlerave etnografike, muzikore, folklorike dhe produktet e kësaj zone.

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
/	Shpenzime teknike		
1	Ofrim shërbimi me stage podium & Foni	komplet	1
2	Ofrim shërbimi me materiale stola & tavolina	komplet	1
/	Pagesa për artistët		
1	Grup muzikor popullor	grup	1
2	Këngëtar popullor i njohur	person	1
3	Këngëtar popullor	person	2
4	Grup i valleve popullore	grup	1

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË ORGANIZIMIT TË FESTËS

Specifikimi i bazës materiale teknike (foni, stage podium, materialet e dekorit) :

1. Fonia duhet të jetë e tipit Array line e cila nënkupton një foni ku bokset qëndrojnë të varur pas skelerisë metalike e cila do të jetë 8 metra e gjerë dhe 5 metra e lartë. Ky tip fonie është i përshtatshëm për aktivitete në terrene të hapura ku fuqia maksimale mund të shkojë rreth 15.000 wat

2. Stage podium duhet të jetë me material alumini me përmasa 6m me 4m.

3. Tavolinat :

- a. Duhet të jenë me material druri.
- b. Përmasat të jenë 1,5 m me 1m.
- c. Ngjyra kafe

4. Stolat :

- a. Duhet të jenë me material druri.
- b. Përmasat të jenë 1,5m me 40cm
- c. Ngjyra kafe

Specifikimi për artistët :

Grupi muzikor popullor

1. Duhet të jetë nga zona e Zharrëzës dhe të përfshihen instrumentet muzikore klarinet, fizarmonikë, def si dhe 1(një) këngëtar i kësaj zone.
2. Duhet të performojnë live(drejtëpërdrejt) melodi dhe këngë të vjetra myzeqare.
3. Koha e programit artistik të tyre duhet të jetë rreth 15 minuta.

Këngëtari popullor i njohur :

1. Duhet të jetë ndër këngëtarët më të pëlqyer në tregun muzikor shqiptar.
2. Të ketë këngë hite të momentit.
3. Të jetë nga trevat e jugut të Shqipërisë (myzeqe, mallakastër, labëri, çamëri).
4. Këngëtari do të këndoje playback rreth 40 minuta nga repertori i këngëve të tij.

Këngëtari popullor

1. Duhet të jetë nga zona e myzeqesë ose zona të jugut të Shqipërisë.
2. Të ketë në repertorin e tij kryesisht këngë për myzeqenë dhe traditat e saj, por dhe këngë nga trevat e jugut të Shqipërisë.
3. Këngëtari do të këndoje playback rreth 20 minuta.

Grupi i valleve popullore

1. Grupi të ketë në përbërje të tij vallëtarë djem dhe vajza.
2. Duhet të jenë me veshje tradicionale myzeqare.
3. Të performojnë valle tradicionale të myzeqesë dhe valle popullore të jugut.
4. Koha e programit të performancës së tyre është rreth 15 minuta.

8. Aktiviteti “Gjithmonë pranë jush”

Me rastin e 1 tetorit, Ditës Botërore të Moshës së Tretë në një nga lokalet e qytetit do të organizohet aktiviteti “Gjithmonë pranë jush” me moshën e tretë të shtresave të ndryshme sociale për t’u përçuar mesazhin e dashurisë njerëzore dhe përkujdesjes ndaj tyre. Pjesëmarrësve do t’u rezervohet një ditë e veçantë në një atmosferë të ngrohtë me poezi dhe këngë nga fëmijët e Qendrës Kulturore.

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
/	Organizimi i aktivitetit	Persona	80

Specifikimet e organizimit të aktivitetit:

1. Lokali duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë Patos për të bërë të mundur transportin e të moshuarve si dhe organizimin e aktivitetit me infrastrukturën e nevojshme.
2. Menuja që do t’u serviret duhet të jetë si më poshtë :
 - a. 1(një) pije freskuese (lëng frutash, coca cola, fanta)
 - b. Fruta të freskëta (mollë, portokalle, kivi, banane)
 - c. Embëlsirë (trileçe ose pjesë torte)

9. Projekti “Sofra bujare”

Festa e Njesisë Administrative Ruzhdie organizohet në datën 20 tetor. Ka si qëllim promovimin dhe reklamimin e ullirit (varieteteve) dhe vajit të tij si dhe punimet artizanale, trashëgimia e vlerave etnografike, muzikore, folklorike e kësaj zone.

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
/	Shpenzime teknike		
1	Ofrim shërbimi me foni	komplet	1

2	Banderolë	copë	1
3	Materiale per panairin	komplet	1
/	Pagesa për artistët		
1	Grup polifonik	grup	1
2	Këngëtar popullor i njohur	person	1
3	Këngëtar popullor	person	1
4	Grup i valleve popullore	grup	1

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË ORGANIZIMIT TË FESTËS

Specifikimi i bazës materiale teknike:

Fonia duhet të jetë e tipit Array line e cila nënkupton një foni ku bokset qëndrojnë të varur pas skelerisë metalike e cila do të jetë 8 metra e gjerë dhe 5 metra e lartë. Ky tip fonie është i përshtatshëm për aktivitete në terrene të hapura ku fuqia maksimale mund të shkojë rreth 15.000wat.

Banderola për në rrugë :

- a.Materiali beze e bardhë
- b.Me certifikatë cilësie
- c.Përmasa 6m me 0.5m
- d.Logoja “GËZUAR FESTËN E RUZHDIËS!”

Specifikimi për artistët :

Grupi polifonik :

- 1.Duhet të jetë grup i njohur i isopolifonisë nga Mallakastra, Tepelena, Vlora, Saranda ose Gjirokastra.
- 2.Grupi duhet të performojë live këngë të vjetra dhe të reja në përshtatje me tematikën e festës dhe zonës.
- 3.Koha e programit të tyre muzikor duhet të jetë rreth 15 minuta.

Këngëtari popullor i njohur :

- 1.Duhet të jetë ndër këngëtarët më të pëlqyer në tregun muzikor shqiptar.
- 2.Të ketë këngë hite të momentit.
- 3.Të jetë nga trevat e jugut të Shqipërisë (mallakastër, labëri, çamëri, myzeqe).
- 4.Këngëtari do të këndoje playback rreth 40 minuta nga repertori i këngëve të tij.

Këngëtari popullor

- 1.Duhet të jetë nga zona e mallakastrës ose zona të jugut të Shqipërisë.
- 2.Të ketë në repertorin e tij kryesisht këngë për mallakastrën dhe traditat e saj, por dhe këngë nga trevat e jugut të Shqipërisë.
- 3.Këngëtari do të këndoje playback rreth 20 minuta.

Grupi i valleve popullore

- 1.Grupi të ketë në përbërje të tij vallëtarë djem dhe vajza.
- 2.Duhet të jenë me veshje tradicionale të zonës së mallakastrës.
- 3.Të performojnë valle tradicionale të mallakastrës dhe valle popullore të jugut.
- 4.Koha e performancës së tyre artistike është 15minuta.

10. Aktiviteti “Ti Shqipëri më jep nder!”

Në datën 29 Nëntor do të organizohet një aktivitet me organizatën e Veteranëve dhe Familjeve të Dëshmorëve të qytetit me rastin e 82-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë veteranë të luftës dhe pasardhës, familjarë të Dëshmorëve të

qytetit, të ftuar nga Komiteti Kombëtar i Veteranëve dhe Komiteti i Veteranëve të Fierit, përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor si dhe intelektualë të qytetit.

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
/	Organizimi i aktivitetit	Persona	63

Specifikimet e organizimit të aktivitetit:

1. Lokali duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë Patos për të bërë të mundur transportin e të ftuarve si dhe organizimin e aktivitetit me infrastrukturën e nevojshme.
2. Menuja që do të serviret duhet të jetë si më poshtë :
 - a. Pjata e parë - mish viçi me patate në furrë
 - b. Pjata e dytë - sallatë mesore (sallatë jeshile, rukola, perime të ziera)
 - c. Salcë kosi
 - d. Një pije freskuese (cola ose fanta, ujë, verë ose birra),

11. Aktiviteti “Ndezja e dritave të pemës së Krishtlindjes në qytet”

Aktiviteti festiv në prag të festave të Krishtlindjes dhe Vitit të Ri. Do të organizohet në sheshin qendror të qytetit me një program muzikor dhe argëtues për të gjithë qytetarët në datën 6 dhjetor 2026. Për ta kthyer qendrën e qytetit në një arenë të madhe festive para dhe pas ndezjes së dritave të pemës do të ketë personazhe artistik si: babagjyshi me dy elfet, moderatori, kllouni, xhongleri, magjistari, këmbëgjati, akrobati, performues.

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
1.	Personazhe artistik	person	8

Specifikimi për artistët :

1. Artistët duhet të jenë të veshur sipas personazhit artistik që performojnë.
2. Duhet të performojnë live në përshtatje me tematikën e festës dhe zonës.
3. Duhet të jenë argëtues dhe miqësor me publikun.
4. Koha e programit të tyre duhet të jetë rreth 60 minuta.

12. Aktiviteti “Dita e Rinisë”

Do të organizohet me rastin e 8 dhjetorit Ditës Kombëtare të Rinisë me maturantët dhe nxënësit e dalluar të gjimnazeve të Bashkisë Patos si dhe talentet në fusha të ndryshme. Do të organizohet në një nga lokalet e qytetit ku do të ndërthuret me stimulimin e më të mirëve me dhurata dhe certifikata vlerësimi, do të ndahen eksperiencia nga të rinj të ndryshëm si dhe elementë artistik me të talentuarit në fushën e artit.

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
1	Organizimi i aktivitetit	persona	150
2	Materiale dekori	komplet	1
3	Certifikata vlerësimi me dosje	copë	30
4	Libra artistik	copë	30

Specifikimet e organizimit të aktivitetit:

1.Lokali duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë Patos për të bërë të mundur transportin e të rinjve si dhe organizimin e aktivitetit me infrastrukturën e nevojshme.

2.Të ftuarve do t'u serviret menuja si më poshtë :

a. 1(një) pije freskuese (lëng frutash, coca cola, fanta)

b.Fruta të freskëta (mollë, portokalle, kivi, banane)

c. Fruta të thata (fistik, bajame, lajthi, kikirik).

Dekori duhet të jetë në përshtatje me tematikën e aktivitetit, pra t'i dedikohet rinisë. Mund të përfshihen postera me thënie motivuese, lule, tullumbace etj.

Specifikimet e certifikatave të vlerësimit:

1.Dosjet duhet të jenë në format A3, material lëkure me ngjyrë vishnje.

2.Certifikata duhet të jetë në karton në format A4, 300 gr, mat e plastifikuar dhe anësoret e certifikatës të jenë në ngjyrë floriri të nxehtë.

2.1.Në pjesën e sipërme të certifikatës duhet të jenë: në anën e majtë logo e Bashkisë Patos, në qendër logo e Republikës së Shqipërisë.

2.2.Në qendër të certifikatës do të jete emri i personit dhe motivacioni (këto do t'i bashkëngjisim ftesës për ofertë), në fund të certifikatës në anën e djathtë Kryetari dhe në anën e majtë qyteti, muaji, viti.

13. Aktiviteti “Festojmë së bashku”

Organizohet në prag të festës së Krishtlindjes dhe Vitit të Ri 2027. Qendra Kulturore do të përgatis një program muzikor i cili do të bëjë bashkë të gjithë nxënësit e dalluar në procesin mësimor-edukativ të shkollave 9-vjecare të qytetit dhe Njësive Administrative të Bashkisë Patos për të cilët do të përgatitet një pako me dhuratë.

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Njësia	Sasia
1	Pako me dhurata	copë	300
2	Baner festiv	copë	1

Specifikimet teknike:

1.Lodrat duhet të jenë të ndryshme, të shumëllojshme dhe të vlefshme për moshat 7-15 vjeç.

2.Lodrat duhet të jenë me material ekologjik, argëtuese dhe cilësore.

3.Lodrat të jenë me certifikim cilësie të miratuar nga organet kompetente, nuk do të pranohet asnjë certifikim cilësie tjetër jo i miratuar.

Aksesorët e tjerë do të jenë sipas këtyre specifikimeve:

1.Kartolinat duhet të jenë me material kartoni cilësor me dizenjo për Vitin e Ri

2.Çantat duhet të jenë mesatare me material kartoni cilësor me dizenjo festive(babagjysh, bredh, dëborë etj).

Specifikimet teknike të banerit:

a.Baneri për skenën duhet të jetë me material PCV

b.Me certifikatë cilësie

c.Përmasat 4,5m me 3,5m

d. Motivët që do të paraqiten në sfond me logon duhet të jenë sipas tematikës së projektit dhe me ngjyra festive.

Kritere specifike të objektit që do të prokurohet:

1. Operatori ekonomik përpara se të shpallet fitues përfundimtar do të paraqes pranë Bashkisë Patos emrat e artistëve që do të ofrojë si dhe repertorin e secilit, për të vlerësuar

artistët që do të performojnë në skenë për projektet “Patosi’Fest”, “Brez pas brezi myzeqar!” dhe “Sofra bujare”.

2. Vlerësimi i artistëve do të kryhet nga specialistët e fushës.

3. Baza materiale për përgatitje dhe dekor duhet të dorëzohen një javë para zhvillimit të aktiviteteve.

4. Pajisjet e infrastrukturës (podium, ndriçim, foni, tavolina, stola) duhet të jenë të montuara 2(dy) orë para fillimit të çdo aktiviteti.

5. Artistët (këngëtarë,vallëtarë,moderator,aktor) duhet të paraqiten 30 minuta para fillimit të aktivitetit.

6. Artistët, stafi teknik dhe stafi realizues marrin përsipër vet shpenzimet e transportit.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr.	Emërtimi	Ofrimi shërbimit	Njësia	Sasia	Kosto financiare
1	“Organizimi i ceremonive zyrtare dhe përkujtimore të datave historike”	gjatë vitit	Shërbim	1	
2	Organizimi i aktivitetit “Në nder të grave të komunitetit”	Gjatë muajit Mars	Shërbim	1	
3	Aktiviteti “Beteja e lirisë”	29 mars	Shërbim	1	
4	Shfaqje teatri	gjatë vitit	Shërbim	1	
5	Aktiviteti “Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe turizmit”	Prill-maj	Shërbim	1	
6	Projekti “Patosi’fest”	Java e III e qershorit	Shërbim	1	
7	Projekti “Brez pas brezi myzeqar!”	29 shtator	Shërbim	1	
8	Aktiviteti “Gjithmonë pranë jush”	1 tetor	Shërbim	1	
9	Projekti “Sofra bujare”	20 tetor	Shërbim	1	
10	Aktiviteti “Ti Shqipëri më jep nder!”	29 nëntor	Shërbim	1	
11	Aktiviteti “Ndezja e dritave të pemës së Krishtlindjes në qytet”	6 dhjetor	Shërbim	1	
12	Aktiviteti “Dita e Rinisë”	9 dhjetor	Shërbim	1	
13	Aktiviteti “Festojmë së bashku”	18 dhjetor	Shërbim	1	
	SHUMA				
	TVSH				
	TOTALI ME TVSH				

Afatet e ekzekutimit:

Nr.	Emërtimi	Ofrimi shërbimit
1	“Organizimi i ceremonive zyrtare dhe përkujtimore të datave historike”	gjatë vitit
2	Organizimi i aktivitetit “Në nder të grave të komunitetit”	Gjatë muajit Mars
3	Aktiviteti “Beteja e lirisë”	29 mars
4	Shfaqje teatri	gjatë vitit
5	Aktiviteti “Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe turizmit”	Prill-maj
6	Projekti “Patosi’fest”	Java e III e qershorit
7	Projekti “Brez pas brezi myzeqar!”	29 shtator
8	Aktiviteti “Gjithmonë pranë jush”	1 tetor
9	Projekti “Sofra bujare”	20 tetor
10	Aktiviteti “Ti Shqipëri më jep nder!”	29 nëntor
11	Aktiviteti “Ndezja e dritave të pemës së Krishtlindjes në qytet”	6 dhjetor
12	Aktiviteti “Dita e Rinisë”	9 dhjetor
13	Aktiviteti “Festojmë së bashku”	18 dhjetor

Nga nënshkrimi i kontratës deri më 31 Dhjetor 2026

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
				Nga nënshkrimi i kontratës deri më 31 Dhjetor 2026

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Organizimi i aktiviteteve do të kryhet sipas të gjitha specifikimeve të kërkuara sëbashku me pajisjet e kërkuara dhe personat sipas Shtojcës 6 në specifikimet teknike, që do të mundësojë organizimin dhe realizimin e aktiviteteve, sipas përcaktimeve që janë bërë në hartimin e termave të referencës.

Organizimi i aktiviteteve konsiston në ofrimin e të shërbimeve, pajisjeve dhe materialeve dhe mbarëvajtjen e çdo aktiviteti gjatë kohës së ofrimit të shërbimit Operatori ekonomik paguhet në bazë të faturave të prera për çdo aktivitet.

Aktivitetet do të kryhen në data të caktuara sipas kalendarit të realizuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos më sipër në Shtojcën 6 në specifikimet teknike. Pajisjet, materialet dhe të gjitha shërbimet (montimi, transporti, vendosja në vendet e duhur) të lidhura me ato do të kryhet nga operatori ekonomik fitues i cili është përgjegjës për ruajtjen dhe performancën e pajisjeve, materialeve dhe shërbimeve.

Qëllimi i shërbimeve:

Institucioni i Bashkisë Patos kërkon të realizoj ‘Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive gjatë vitit 2026’ me të gjitha pajisjet, materialet dhe shërbimet që kërkohen në Shtojcën 5 Specifikimet teknike. Me organizimin e këtyre aktiviteteve synohet realizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive gjatë vitit në nivel cilësorë dhe të përshtatshëm, duke eliminuar problematikat e shumta të gatishmërisë së tyre për shkak të vonesave të ndryshme dhe mungesës apo cilësisë së ulët së organizimit në evente dhe aktiviteve për rastin e festave dhe datave të shënuara.

Detyrat:

Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive gjatë vitit konsiston në ofrimin e të gjitha të gjitha shërbimeve, pajisjeve dhe materialeve për realizimin e aktiviteteve. Operatori ekonomik ka për detyrë të ofrojë të gjitha pajisjet, materialet dhe shërbimet dy orë përpara fillimit të çdo aktiviteti.

Operatori ekonomik ka përgjegjësi ruajtjen, vendosjen dhe montimin e të gjitha pajisjeve si dhe ruajtjen e performancës së dëshiruar teknike që ofrojnë këto pajisje.

Operatori ekonomik në çdo moment ka për detyrë të raportoj tek punonjësi përgjegjës në lidhje me organizimin, pajisjet, materiale dhe shërbimet e ofruara për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive gjatë vitit.

Ofrimi i shërbimit do të jetë i pandalshëm gjatë gjithë programit artistik të përcaktuar nga autoriteti kontraktor sipas përcaktimeve që vijnë në më poshtë.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Në territorin e Bashkisë Patos.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

